O i Dërguari i Allahut, ndaj kujt duhet të jem më i përkushtuar? Ai tha: “Ndaj nënës sate, pastaj ndaj nënës sate, pastaj ndaj nënës sate, pastaj ndaj babait tënd, pastaj më i afërmi e kështu me radhë.”

Bahz ibn Hakimi transmeton nga babai i tij, nga gjyshi i tij, se ai ka thënë: O i Dërguari i Allahut, ndaj kujt duhet të jem më i përkushtuar? Ai tha: “Ndaj nënës sate, pastaj ndaj nënës sate, pastaj ndaj nënës sate, pastaj ndaj babait tënd, pastaj më i afërmi e kështu me radhë.”

[Hasen] [Transmetojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ahmedi]

Profeti në këtë hadith sqaroi se personi që më së shumti e meriton përkushtimin, mirësinë, trajtimin e mirë, shoqërimin e këndshëm dhe mbajtjen e lidhjeve familjare është nëna. Ai theksoi të drejtën e saj mbi të tjerët, duke e përsëritur tri herë, për të treguar vlerën e saj mbi të gjithë njerëzit pa përjashtim. Pastaj Profeti sqaroi se kush vjen pas saj në përkushtim, duke thënë: pastaj babai, e më pas të afërmit sipas shkallës së afërsisë; sa më i afërt të jetë i afërmi, aq më shumë e meriton mbajtjen e lidhjeve, sesa ai që është më i largët.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/58188